



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2024 kishte kryer pagesa dhe regjistruar shpenzime në vlerë 796,913€ nga kategoria ekonomike joadekuata si rezultat i pagesave nga thesari me vendime gjyqësore dhe 89,000€ si shkak i planifikimit jo të duhur të buxhetit nga vet Ministria;
- A2 Në vitin 2024 Policia e Kosovës kishte paguar shtesat për kushte specifike të punës në vlerë prej 55,550€ edhe për zyrtarët që në këtë periudhë kishin qenë të suspenduar;
- A3 Pasuritë ishin të nënvlerësuar për 162,056€, si pasojë e zhvlerësimit para kohe dhe mos regjistrimit të pasurive;
- B1 Punonjësit e komunitetit serb edhe gjatë vitit 2024 ishin paguar në vlerë prej 112,924€ pa vjueshmëri në punë;
- B2 Detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 336,732€ si rezultat i mos përditësimit të të dhënave edhe në rastet kur ato ishin paguar.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A4 Mangësi në fushën e prokurimit si: vlerësimi i ndryshëm i kriterëve të njëjta, moskonfiskim i sigurisë së tenderit dhe kërkesat e AK për zgjatje të vaditetit ishin bërë me vonesë.
- B3 Policia e Kosovës vazhdon të paguaj me 50% të pagës bazë më gjatë se gjashtë muaj 69 zyrtarë të suspenduar; dhe
- B4 Rreth 341 staf policor ushtrojnë funksionin e punës për të cilat kërkohet gradë më e lartë si pasojë e ngecjes në procesin e gradimit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Kontratat dhe pagesat në kategoritë si investime kapitale dhe mallra shërbime të cilat ishin të klasifikuara (niveli i kufizuar) nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto kontrata dhe pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse. Përderisa lëndët që e kanë nivelin e klasifikimit Sekret dhe Konfidencial nuk janë audituar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MPB-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat me probleme më të theksuara të shpenzimit kanë të bëjnë me menaxhimin e financave që ndërlidhen me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, kompensimi i shtesave jo në përputhje me rregulloren, kompensim i pagave pa vijueshmëri në punë, regjistrimi jo i duhur i pasurisë dhe prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente.

Ndërsa, sa i përket mospajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, ministria duhet të i forcoj edhe më tej kontrollet sa i përket: shqyrtimit të kompensimit të pagës bazë prej 50% përtej afateve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ, ushtrimi i funksioneve të punës të Policia e Kosovës për të cilat kërkohen grada më të larta, dhe menaxhimin e kontratave ku kishte mangësi në fushën e prokurimit si dhe vonesave në realizimin e punimeve.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre katër (4) rekomandime të reja dhe pesë (5) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18.3 të Rregullës financiare nr.01/2013- Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

MPB në vitin 2024 kishte kryer pagesa si rezultat i vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë prej 3,291,193€. Bazuar në testimet tona ne identifikuam se klasifikimet jo adekuate të shpenzimeve ishin në vlerë prej 885,913€, si në vijim:

- Shpenzimet me vendime gjyqësore-përmbartimore në vlerë 1,118,895€ ishin kryer nga kategoria mallra dhe shërbime. Nga kjo shumë 736,913€ kishin të bënin me borxhin kryesor për pagesën e pagave shtesë dhe duhej të ishin paguar nga kategoria paga dhe mëditje kurse pjesa tjetër prej 381,982€ ishin shpenzime të përmbartimit, interesit, ekspertizës etj. që ishin paguar nga kategoria adekuate mallra dhe shërbime.

Po ashtu, për të njëjtin qëllim ishin shpenzuar 60,000€ nga kategoria e investimeve kapitale. Këto mjete ishin marr nga Inspektoriati i Policisë së Kosovës për ezekutimin e pagave të PK-së. Pjesa prej

50,326€ duhej të paguhej nga kategoria e pagave dhe mëditjeve kurse pjesa tjetër 9,674€ nga mallrat dhe shërbimet.

Këto pagesa ishin bërë në emër të shpërblimit për fund vit në vlerë të një page të rregullt mujore (kalkulimi ishte bërë nga viti 2018 deri në hyrjen në fuqi të ligjit të pagave) bazuar në nenin 29 të UA nr. 02/2018 të Policisë-MPB. Pagesat ishin kryer nga Thesari dhe vetëm kishin njoftuar Ministrinë për konfirmim të obligimit. Edhe pagesat tjera që ishin bërë me vendime gjyqësore-përmbartimore ishin të natyrës së ngjashme dhe për qëllime të njëjta.

- Shpenzimet në vlerë 89,000€ për “Furnizim me drita rotative (alarma) për automjetet e PK-së” ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime si mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve. Për nga natyra dhe vlera individuale e tyre (vlera mbi 1,000€), ato duhej të paguheshin nga kategoria e investimeve kapitale.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mospagesës së tyre ndër vite dhe ankesave të zyrtarëve policor nëpër gjykata dhe te përmbartuesit e ku vendimet e gjykatave ishin në favor të zyrtarëve policor. Po ashtu, me planifikimet buxhetore të vitit 2024 këto mjete nuk ishin ndarë për këtë qëllim dhe përkundër që menaxheri i financave të Policisë për secilën pagesë i kishte informuar zyrtarët e thesari që shpenzimi i takon dhe duhet të paguhet nga kategoria paga dhe mëditje kjo nuk kishte ndodhur por që thesari i kishte paguar aty ku kishte gjetur mjete të lira dhe për pasojë kemi keqklasifikim të shpenzimeve.

Ndikimi

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar /nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse. Po ashtu, klasifikimi jo i drejtë i shpenzimeve, çorienton shfrytëzuesit e këtyre informatave të prezantuar gabimisht në PFV dhe mund të ndikon në vendimmarrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet planifikohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e shpenzimeve nga kategoria e duhur. Kjo duhet të ndërmerret me qëllim të prezantimit të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Kompensimi i shtesave jo në përputhje me rregulloren**Gjetja**

Rregullorja (QRK) nr. 08/2023 Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, në nenin 6 pika 1 përcakton se Shtesa për kushte specifike të punës është shtesë mujore që përfitohet nga zyrtarët publik dhe të punësuarit e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë së shtuar në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. Kurse pika 2 e nenit 6 specifikon se kategoritë e pozitive që do ta marrin këtë shtesë duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim: - hetimi në teren, ku për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës; dhe - kryerja e detyrave në operacione të rrezikshme, të cilët për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës.

Po ashtu, për këtë lloj të shtesës Qeveria ka formuar komision të veçantë për përpilimin e listës së pozitive të cilat mund të përfitojnë shtesën për kushte specifike të punës i cili komision ka përcaktuar nivelet e shtesave dhe pozitat të cilat mund të jenë përfitues. Propozimi i komisionit është aprovuar nga Qeveria me vendimin nr.02/173, të datës.16.11.2023.

Përfitues të kësaj shtese ishin edhe stafi policor i Kosovës. Ne identifikuam se shtesën e plotë për kushte specifike të punës ishin duke e marrë edhe 65 zyrtarë policor të suspenduar, bazuar në listën e pagave të ofruara nga PK edhe pse ata nuk ishin duke e ushtruar funksionin e rrjedhimisht edhe nuk kishin ndonjë rrezikshmëri. Në vitin 2024 për zyrtarët e suspenduar shtesat për kushte specifike të punës ishin në vlerë prej 55,550€, (përderisa pagën ishin duke e marrë prej 50% siç parashihet me rregullore).

Sipas zyrtarëve përgjegjës kjo kishte ndodhur si rezultat i kohës së shkurtër për dërgimin e listave me personat e kualifikuar për shtesën për kushte specifike. Ne vlerësojmë se gjatë vitit nuk ishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret për të shqyrtuar çështjen e zyrtarëve policorë të suspenduar nëse edhe ata duhet të përfitonin këtë shtesë.

Ndikimi

Pagesat e shtesave për kushtet specifike për zyrtarët e suspenduar dhe jo në përputhje me rregulloren ndikon në dëmtimin e buxhetit të Ministrisë dhe mund të reflektoj në de-motivimin e zyrtarëve tjerë policor të cilët përballen direkt me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës në teren.

Rekomandimi A2

Ministri në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë duhet të sigurojnë që pagesat e shtesave për kushte specifike të punës jepen vetëm për stafin që gjatë operimit në punë ballafaqohet me rrezikshmëri siç është specifikuar në kriteret e rregullores për përfitimin e kësaj shtese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Regjistrimi jo i duhur i pasurisë**Gjetja**

Sipas Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare neni 22 zhvlerësimi i pasurisë jo financiare pika 1 dhe 2 përcakton që "Zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore. Pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes". Ne identifikuam se pasuritë ishin të nënvlerësuara për 162,056€ si në vijim:

- Paisjet "Kabinet metali për vendosjen e armëve te gjata" te Policia e Kosovës në vlerë 61,630€ (590€/copa) që ishin blerë me datë 10.10.2024, ishin evidentuar në regjistrin e pasurive nën 1000€, mirëpo në fund të vitit ato ishin zhvlerësuar në tërësi (norma e zhvlerësimit 6 vite) dhe në fund vit vlera e tyre në regjistrin e pasurive ishte zero (0). Pasuritë ishin nënvlerësuar për 59,656€.
- Paisjet "Drita rotative (alarma) për automjetet e Policisë së Kosovës", në vlerë 89,000€ nuk ishin evidentuar në regjistrin e pasurive në SIMFK; dhe
- Në dy raste pasuritë ishin regjistruar sipas vlerës së pagesës e jo sipas vlerës së faturës siç do të duhej nga fakti që në këto pagesa ishin aplikuar penalet për mospërmblidhje të kontratës me kohë. SNK 16 e thekson qartë çka përfshin kostoja e një pasurie të blerë. Kjo kishte ndodhur te pagesat si: a). Automjete të zjarrfikësve dhe shpëtimit të cilat ishin nënvlerësuar për 7,500€; dhe b.) Softueri ishte nënvlerësuar për 5,900€.

Sipas zyrtarëve të Policisë së Kosovës, çështja e zhvlerësimit ishte si pasojë e problemeve teknike gjatë regjistrimit të këtij artikulli në sistem dhe pas identifikimit nga ana jonë kjo është rregulluar. Kurse ulja e vlerës së pasurive përshkak të aplikimit të penaleve kishte ndodhur pasi që zyrtarët e pasurive nuk ishin mjaftueshëm në njohuri se si duhet të bëhet regjistrimi i pasurive në raste të tilla.

Ndikimi

Regjistrimi jo i duhur i pasurive ndikon në raportimin jo të drejtë të vlerës së pasurive dhe menaxhimin e tyre. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të vlerës së tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të financave dhe zyrtarëve të pasurive që të gjitha pasuritë janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive të korrigjohen në mënyrë që vlera e prezantuar e pasurive të jetë e plotë dhe e saktë duke përfshirë edhe zhvlerësimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B1 - Kompensim i pagave pa vijueshmëri në punë****Gjetja**

Neni 17, paragrafi 1 i Rregullores (QRK) nr. 04/2024 Për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik përcakton se: "Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë kurse paragrafi 5 potencon se "Mungesa e evidentimit të vijueshmërisë në punë nga zyrtari llogaritet si mungesë në punë".

Bazuar në vendimin e Qeverisë Nr.06/39 i dt.22.07.2015, ish MAP, ishte e obliguar t'i sistemoj 20 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integritetit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës nuk kishin punuar asnjëherë për ministrinë që nga nënshkrimi i akt emërimeve të tyre, përderisa njëri vullnetarisht kërkon ndërprerjen e marrëdhënies së punës në gusht 2024. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët relevant, për të njëjtit nuk kishte dëshmi të vijueshmërisë në punë. Vlera e pagesave të realizuara për këta punonjës për vitin 2024 ishte 112,924€.

Kjo dukuri vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmerë masa konkrete në sistemin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

Ndikimi Pagesat e pagave në mungesë të vijueshmërisë në punë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Gjetja Rregullorja MF nr.01/2017, neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PVF. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen. Ne identifikuam se detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar për 336,732€ si në vijim:

- Nga pagesat për vendime gjyqësore kemi vërejtur se 118 padi ishin paguar në vlerë prej 276,428€, përderisa ende figuronin në listën e detyrimeve kontingjente dhe ishin prezantuar në PVF, duke i mbivlerësuar për këtë vlerë;
- Lënda me numër IV.C.nr.379/17 bashkuar IV.EK.C nr.435/17 në listën e detyrimeve kontingjente dhe në pasqyra financiare ishte dyfishuar dhe prezantuar në vlerë 96,051€, ndërsa vlera e saj nga dokumente burimore ishte 49,671€ me një mbivlerësim prej 46,379€; dhe
- Lënda me numër C.nr.823/19, paditësit kishin tërheqë padinë kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme në vlerë prej 13,925€, ndërsa figuronte në regjistrin e detyrimeve kontingjente dhe në PVF, (mbivlerësim prej 13,925€).

Mos përditësimi i listës së detyrimeve kontingjente nga zyra ligjore me të dhënat e fundit nga proceset kontestimore ishte shkak i kryesor i mbivlerësimit të detyrimeve kontingjente.

Ndikimi Kjo ka ndikuar në mbivlerësimin dhe prezantimin jo të drejtë të detyrimeve kontingjente në Pasqyra Vjetore Financiare.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj një kordinim në mes zyrës ligjore dhe ZKF-së në mënyrë që detyrimet kontingjente të jenë të përditësuara në fund të vitit me qëllim që të prezantohen drejtë dhe në përputhje me kërkesat e rregullores për Raportim Vjetor Financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Mangësi në fushën e prokurimit

Gjetja

Procedurat e prokurimit publik duhet të zhvillohen në përputhje me ligjin dhe rregulloret e prokurimit publik. Kriteret e vendosura në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të respektohen në plotëni. Ne identifikuam se:

- Kriteri i aplikuar në dosje të tenderëve që të ofrohen "kontrata të natyrës së njëjtë apo të ngjashme" ishte vlerësuar nga ana e Autoritetit kontraktues në mënyra të ndryshme, në dy procedura të prokurimit. Në procedurën "Ndërtimi i objektit të garazhës në kampin Enver Zymberi - Mitrovicë", janë refuzuar kontratat që lidhen me renovime të objekteve dhe për masat e efijencës së energjisë si jo të ngjashme dhe këtë qëndrim e ka mbështetur edhe OSHP me një vendim në favor të Autoritetit Kontraktues. Ndërsa në procedurën tjetër të "Ndërtimi i aneksit dhe katit - DPR Prishtinë", kontratat e renovimeve janë pranuar si të vlefshme. Kjo tregon se nuk kishte pasur vlerësim-trajtim të barabartë të kriterëve nëpër procedura të ndryshme.
- Në tenderin "Furnizim me drita rotative (alarma) për automjetet e PK-së" kishin ofertuar dy (2) operatorë ekonomik. Operatori ekonomik më i lirë ishte shpallur i papërgjegjshëm. Sipas komisionit të vlerësimit operatori në fjalë kishte ofruar një katalog të prodhuesit italian dhe një katalog që duket se ka elemente të prodhuesit turk dhe vlerësimi i specifikave ka qenë i pamundur të bëhet, ashtu siç kërkohej në dosjen e tenderit. Zyra e prokurimit me datë 31.01.2024 kishte kërkuar sqarim me shkrim nga prodhuesi italian, të cilët kishin deklaruar se këto drita nuk prodhohen më që nga fillimi i vitit 2024, përderisa autorizimi i ishte lëshuar me datë 04.01.2024. Zyra e Prokurimit në këtë rast e ka vlerësuar operatorin ekonomik si i papërgjegjshëm në vlerësim dhe nuk kishte marrë parasysh konfiskimin e sigurimit të tenderit ashtu siç e parasheh parasheh neni 57 i LPP-së të pika 1.1 kur informacionet janë të prezentuara si të pasakta në ofertë.

Mos konfiskimi i sigurisë së tenderit kishte ndodhur si rezultat i neglizhencës nga ana e zyrës së prokurimit.

- Validiteti i ofertave nuk e kishte mbuluar tërësisht periudhën, siç kërkohej me nenin 30.4 të rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, tek Procedurat e prokurimit si
 1. Te projekti - "Lot 1 Qendra për Vlerësim dhe Standarde - QVS" dhe Vazhdimi i punimeve Lot 2 - "Akademia e Drejtësisë AD Prishtinë - faza II" zgjatja e validitetit ishte kërkuar me vonesë nga AK nga 9 deri në 17 ditë; dhe
 2. Te procedura "Ndërtimi SHFMU në Pozharan" - Komuna e Vitisë zgjatja e validitetit ishte kërkuar me vonesë nga AK nga 8 deri në 24 ditë.

Shkaku i mangësive në fushën e prokurimit ishte moskujdesi i duhur në ndjekjen e procedurave në lidhje me zgjatjen e afatit të validitetit dhe konfiskimit të sigurisë së tenderit, kurse vlerësimi i tenderëve në lidhje me

kriterin e njëjtë nuk kishte marrë për bazë vendimet paraprake të OSHP-së.

Ndikimi

Vlerësimi i kriterëve të njëjta në mënyra të ndryshme, moskonfiskimi i sigurisë së tenderit kur OE nuk ofrojnë informata të sakta dhe vonesat në zgjatjen e validitetit të ofertave tregojnë anashkalimin e rregullave të prokurimit të cilat mund të ndikojnë në transparencën e procesit dhe koston e kontratave të arritura përmes proceseve të prokurimit.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit procese vlerësuese të drejta të kriterëve dhe në rastet kur ofertuesit ofrojnë informacione të gabueshme dhe janë të papërgjegjshëm duhet t'iu konfiskohet siguria e tenderit. Po ashtu, duhet siguruar një monitorim të rregullt e sistematik të afateve në lidhje me validitetin e ofertave kur proceset e vlerësimit për arsye të justifikueshme zgjasin përtej afateve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Kompensimi përtej afateve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ

Gjetja

Udhëzimi Administrativ 02/2023 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës në nenin 78 paragrafi 2, përcakton që "Suspendimi nga puna mund të zgjasë më së shumti 6 muaj. Pas kësaj periudhe punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t'ia shkëpusë kontratën e punës. Gjatë kësaj periudhe kohore të punësuarit i takon kompensimi në pagë në lartësi prej 50% të pagës".

Në Policinë e Kosovës numri i zyrtarëve të suspenduar të cilët vazhdojnë të kompensohen më gjatë se gjashtë muaj deri në fund të viti 2024 ishte 69. Nga lista e zyrtarëve të suspenduar e pranuar nga stafi përgjegjës i PK-së vërehet se kishte edhe zyrtarë policorë që ishin suspenduar që nga viti 2022 dhe ende vazhdojnë të kompensohen me 50% të pagës. Suspendimi i zyrtarëve policor kryesisht ishte bërë nga Inspektorati Policor.

Kjo dukuri po ndodh pasi që suspendimi i përkohshëm nga Inspektorati Policor i Kosovës, bëhet kryesisht për vepra penale dhe se trajtimi i rasteve të tilla nga Gjykatat bëhet në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili nuk parasheh afat gjashtë (6) muaj për përfundimin e suspendimit. Udhëzimi administrativ 02/2023 nuk ka ofruar shtjellim të rasteve kur vendimi nuk mund të merret brenda afatit gjashtë (6) muaj si rezultat i veprave penale.

Ndikimi

Mos definimi i qartë nga Udhëzimi Administrativ në lidhje me rastet kur vendimi i të suspenduarve varet nga institucionet gjyqësore dhe zgjat më shumë se gjashtë (6) muaj po ndikon në kosto shtesë për buxhetin e Policisë së Kosovës, duke ulur disponueshmërinë e fondeve për nevojat tjera buxhetore.

Rekomandimi B3

Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të rishikojnë Udhëzimin Administrativ 02/2023 në lidhje me periudhën e kompensimeve në pagë për të suspenduarit, duke e definuar qartë cilat janë veprimet konkrete që duhet të ndërmerren pas skadimit të afatit të kompensimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B4 - Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat****Gjetja**

Neni 38, paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 02/2023 mbi marrëdhënien e punës në PK, përcakton se: me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë secili zyrtar i Policisë mund të caktohet në një vend të punës apo transferohet prej një vendi në vendin tjetër të punës nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për atë vend të punës, pa marrë parasysh nivelin, pozitën apo gradën. Udhëzimi Administrativ nr.02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policor përcakton kriteret që duhet t'i plotësoj secili Zyrtar Policor për pjesëmarrje në gradim dhe procesin e testimit që duhet t'i nënshtrohet për të marrë gradën e caktuar. Struktura organizative e Policisë së Kosovës përcakton gradën e kërkuar për secilën pozitë të punës.

Sipas informatave të ofruara nga Drejtoria e Personeli të PK, një numër i zyrtarëve policorë vazhdon të jetë i sistemuar në pozita pa e plotësuar kriterin e gradës që e kërkon ajo pozitë sipas strukturës organizative. Në vitin aktual rreth 341 staf policor ushtronin funksionin për të cilat kërkohet gradë më të lartë e që në raport me vitin paraprak ky numër ishte rritur për 156 (Në vitin 2023 ishin 185 pozita të tilla). Në muajin shkurt të vitit 2024, PK ka shpallur konkursin për procesin e gradimit në gradën Rreshter, mirëpo pas përfundimit të testimit me shkrim dhe me rekomandim të IPK-së si dhe me qëllim të harmonizimit të aktit nënligjor që rregullon fushën e gradimeve me ligjet dhe aktet në fuqi ky proces është anuluar.

Shkak i kësaj gjendje ishte implementimi i strukturës organizative ku janë krijuar departamente/divizione/ drejtori të reja dhe situata e krijuar në veri të vendit ku për nevoja operationale policore, pozitat menaxheriale janë plotësuar me grada jo përkatëse, si dhe dështimi i procesit të gradimit për rreshter.

Harmonizimi i akteve nënligjore sipas Planit Legjislativ të Akteve Nënligjore të MPB-së pritet të miratohet gjatë vitit 2025.

Ndikimi

Sistemimi i stafit në pozita që nuk janë në përputhje me gradën adekuate mund të ndikoj që pozitat e punës të ushtrohen nga persona me mungesë të kompetencës profesionale.

Rekomandimi B4

Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë përshpejtimin e harmonizimit të akteve nënligjore dhe organizimin e proceseve të gradimit në mënyrë që të zvogëlohet në vazhdimësi mbajtja e pozitave nga stafit policor që nuk janë në përputhje kriterin e kërkuar për vendin e caktuar të punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 60,062,815€, prej tyre ishin shpenzuar 44,281,842€ apo 74%. Ato kanë të bëjnë me xhipa dhe kombibus, veturat e shërbimit policor, pajisje të teknologjisë informative, kompjuter, softuer, pasuri e paprekshme etj.

Çështja B5 - Vonesa në realizimin e punimeve

Gjetja

Në kushtet e kontratës janë përcaktuar afatet bazuar në planin dinamik për përmbushjen e secilës kontratë. Ne identifikuar se:

- Gjatë ekzaminimit fizik të projektit të Policisë së Kosovës “Ndërtesat e Administratës Afariste” në vlerë 747,477€ identifikuar vonesa të theksuara në përmbushjen e kontratës në periudhën kur ajo në bazë të afateve të përcaktuara do të duhej të ishte e përfunduar. Kontrata ishte nënshkruar me datë. 22.04.2024 me afat të përfundimit 10 muaj, dhe nga ekzaminimi në prill 2025 vërehet se ishte realizuar vetëm 48%. Vonesat ishin shkaktuar nga fakti që projekti kishte mangësi dhe gjatë ekzekutimit nga punëkryesi janë evidentuar gabime dhe mospërputhje teknike në projekt dhe pengesa tjera, të cilat kërkonin ndryshime për të mundësuar realizimin e projektit;
- Në projektin “Ndërtimi i objektit të mensës në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike” në vlerë 1,064,338€ kishte vonesa në përmbushjen e kontratës. Kontrata ishte nënshkruar me datë 25.11.2022 dhe sipas planit dinamik ishte paraparë të përfundoj brenda 365 ditësh. Autoriteti kontraktues për shkak të vonesave të vazhdueshme në përfundimin e punimeve nga OE, kishte iniciuar procedurën për shkëputje dhe kishte shkëputur kontratën me datë 16.07.2024.
- Projekti “Ndërtimi i objektit të trajnimeve AME” në vlerë 774,000€, kishte vonesa mbi një vjeqare dhe ende projekti nuk ishte finalizuar. Kontrata ishte nënshkruar më datë 09.12.2020, dhe ishte paraparë të përfundoj në një afat prej prej 36 muajsh. Gjatë ekzaminimit të projektit në prill 2025, ne kemi vërejtur se ende projekti nuk ishte përfunduar plotësisht. Në këtë vonesë të konsiderueshme kishte ndikuar edhe ndryshimi i lokacionit, i cili ishte bërë për shkak se projekti ideor i ndërtimit i bërë nga vet MPB kishte mospërputhje me terrenin.

Vonesat në përmbushjen e kontratave ishin si rezultat i mangësive në projekt, papërgjegjësisë së OE-ve dhe menaxhimit jo të mirë të kontratave.

Ndikimi

Mospërputhja e projekteve teknike me gjendjen reale në terren, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave ndërtimore e në raste të caktuara ndërprerja e tyre mund të ndikoj konteste kontraktuale dhe në rritjen e kostos të projekteve, për shkak të nevojës për përshtatje të projekteve gjatë fazës së zbatimit. Këto reflektojnë në mos arritjen e objektivave të parapara me buxhetin e vitit aktual dhe vështirësi financiare për vitin e ardhshëm duke kufizuar mundësinë e realizimit të projekteve të reja.

Rekomandimi B5

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve përkatës se procesi i

hartimit të projekteve ka përfshirë analizën e gjendjes reale në terren përpara finalizimit dhe tenderimit të tyre. Po ashtu, duhet forcuar kontrollet dhe mbikëqyrjen teknike gjatë zbatimit të kontratave, për të eliminuar vonesat me qëllim që projektet të jenë të gatshme në kohën kur janë planifikuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	216,523,467	238,922,623	219,685,060	202,668,133	149,563,945
Grante Qeveritare - Buxheti	207,774,338	229,961,924	218,878,860	201,586,333	149,061,696
Financimi përmes huamarrjes	1,246,750	1,246,750	0	0	0
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	6,611,250	6,611,250	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	92,897	91,290	391,130	0
Të hyrat vetanake	891,129	891,129	671,616	677,126	499,999
Donacionet e jashtme	0	118,672	43,294	13,544	2,250

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 22,399,156€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2024 Ministria ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 219,685,060€ me një përqindje të njëjtë si në vitin paraprak. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	216,523,467	238,922,623	219,685,060	202,668,133	149,563,945
Pagat dhe mëditjet	107,742,926	126,788,071	126,772,563	118,547,111	91,247,431
Mallrat dhe shërbimet	40,128,521	46,323,037	43,369,289	38,123,378	33,440,224
Komunalitë	4,950,400	4,057,351	3,858,358	3,667,840	3,455,676
Subvencionet dhe transferet	2,141,367	1,691,348	1,403,008	1,350,281	1,204,022
Investimet Kapitale	61,560,253	60,062,815	44,281,842	40,979,522	20,216,592

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 19,045,145€. Rritja ishte bërë me vendimet e Qeverisë për shkak mungesës së buxhetit të Policia e Kosovës. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 6,194,516€. Rritja ishte ndikuar si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë dhe transfereve të lejuara nga MFPT. Shuma prej 3,227,374€ e ekzekutuar për pagesa të vendimeve Gjyqësore, kishte ndikuar në kërkesën për rritjen e shpenzimeve nga kjo kategori. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte 94%;
- Buxheti final i shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 893,049€ si rezultat i kursimeve buxhetore sipas vendimit të Qeverisë dhe vendimeve për transfere në mes të kategorive ekonomike. Realizimi i buxhetit në kategorinë e shërbimeve komunale ishte 95%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 450,019€. Ky ndryshim ishte rezultat i kursimeve buxhetore bazuar në vendimet e Qeverisë si dhe transfereve buxhetore të brendshme. Realizimi i buxhetit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte 83%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,497,438€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale ishte 74%. Në këtë nivel të ulët të realizimit kanë ndikuar vonesat në iniciimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit, ngecjet në realizimin e projekteve, si dhe si pasojë e shqyrtimit të ankesave në OSHP.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga MPB në 2024 ishin në vlerë 89,689,786€. Të hyrat e realizuara rrjedhin nga taksat për regjistrimin e automjeteve, taksat rrugore, taksa për dokumente të udhëtimit, gjoba në trafik dhe taksa tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	82,493,128	82,493,128	89,689,786	72,506,267	69,677,161
Të hyrat jo tatimore	82,493,128	82,493,128	89,687,979	72,498,329	69,674,022
Të hyrat tjera	0	0	1,807	7,939	3,139

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. MPB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, mirëpo nuk ka dorëzuar Raportin e progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me 30 shtator dhe 15 mars.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, ne kemi identifikuar se dy (2) rekomandime ishin zbatuar dhe pesë rekomandime ishin përsëritur siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Detyrimet	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës (PK) duhet të sigurojë që detyrimet kontigjente të prezantohen në vlera të sakta si dhe të mbahen evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk është adresuar
2.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk është adresuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.	Për vitin 2024 kjo çështje vazhdon ende të mbetet e pazgjidhur, numri i pozitave në krahasim me vitin e kaluar ishte rritur.	Nuk është adresuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që të zbatohen me saktësi kufizimet kohore dhe kompensimet në pagë sipas rregulloreve në fuqi, duke shmangur shkeljet dhe moskuptimet e mundshme.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk është adresuar
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se para inicimit të aktiviteteve të prokurimit për projekte paraprakisht të kryhen analizat e duhura buxhetore në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike duke përfshirë edhe procesin e shpronësimeve.	Edhe në vitin 2024 janë identifikuar raste të ngjashme.	Nuk është adresuar
6.	Pasuritë	Ministri duhet që nëpërmjet zyrtarëve relevant të sigurojë se komisionet e inventarizimit hartojnë raportet e inventarizimit me kohë, me qëllim të krahasimit të raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, të bëhet vlerësimi i pasurive me qëllim të pasqyrimit të saktë dhe të drejtë të gjendjes së regjistrave të pasurisë së ministrisë.		I zbatuar
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të forcoj kontrollet për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të siguroj se rastet e proceduara në gjykatë të mos përfshihen në regjistrin e llogarive të arkëtueshme dhe shpalosjen e drejtë të hyrave në PFV.		I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit




Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Altina Selimi Palushi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mangësi në fushën e prokurimit	Ne lidhje me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i aneksit dhe katit - DPR Prishtinë" Drejtoria e Prokurimit komisioni i vlerësimit ne harmoni me LPP- ne, rregulloren për prokurim publik njoftimin per kontrate FDT-ne ka vlerësuar aktivitetin e prokurimit dhe ka trajtuar ne mënyrë te barabart te gjithë OE pjesmarrës ne harmoni me nenin 1, 6, 7, 59, 72 dhe ne harmoni me vendimin e OSHP-se ka trajtuar te gjitha kriteret teknike profesionale tek ky aktivitet i prokurimit ashtu siç ju kemi njoftuar edhe ne takimet. OE pjesëmarrës i rekomanduar për kontratë ka prezantuar kontrata te realizuara ne fushën e ndërtimit për te cilat AK Policia e Kosovës komisioni i vlerësimit ka trajtuar ne mënyrë te barabart, dhe ka rekomanduar OE e përgjegjshëm me çmimin me te lirë duke zbatuar nenin 1 qëllimin e kontratës, nenin 6 ekonomikitetin dhe efikasiteti dhe nenin 7 trajtimin dhe jo diskriminimin sipas LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit AK nuk ka pranuar asnjë kërkesës për rishqyrtim as ne shkallen e parë as ne shkallen e dy gjë qe dëshmon ne vendimmarrjen e drejt për te gjithë OE pjesëmarrës dhe kjo eshte nje paraeter matës i performances ne aktivitetin e prokurimit. Te gjitha materialet për aktivitetin ne fjalë i janë prezantuar me qasje të plote ne sistem te E- rokurimit dhe ne takime verbale gjate fazës se auditmit. Polica e Kosovës Drejtoria e Prokurimit ka vlerësuar ne harmoni me ligjin dhe rregulloren për	Gjatë fazës së auditimit, janë shqyrtuar dhe diskutuar të gjitha materialet e ofruara në sistemin elektronik të prokurimit. Autoriteti Kontraktues nuk ka aplikuar standardin e njëjtë gjatë procesit të vlerësimit në këtë procedurë tenderuese e që në një procedurë tjetër ishte aplikuar një praktikë e vlerësimit për të cilën kishte marrë edhe konfirmim nga OSHP. Bazuar në dokumentacionin ekzistues dhe mungesën e provave të reja mbështetëse, gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara. Gjetja nuk i referohet nenit 65 dhe 99.2 të LPP-së, por nenit 57.1 të LPP-së, që i jep të drejtë AK të

prokurim publik për aktivitetin furnizim me drita rrotative ku gjate fazës se vlerësimit AK ka kërkuar sqarime mbi autorizimet për pjesëmarrjen ne ketë aktivitet te prokurimit te cilat i ka prezantuar edhe para Auditorëve ku prodhuesi ka autorizuar një kompani për pjesëmarrje ne ketë aktivitet te prokurimit dhe komunikimet zyrtare qe AK i ka realizuar gjate muajit janar te viti 2024 gjate procesit te vlerësimit prodhuesi ka deklaruar se ka lëshuar autorizimin dhe katalogun ne fjalë dhe për te njëjtin ka deklaruar përmes emailit zyrtar se nuk e prodhojnë me nga fillimi i vitit 2024 për këto gjeni te bashkangjitur dëshmitë te cilat edhe janë rezantuar, Ne asnjë format Drejtoria e Prokurimit nuk ka neglizhuar asnjë vendim marrje por ne mënyrë te barabartë i ka trajtuar te gjithë OE dhe rastin konkret OE pjesëmarrës ne ketë aktivitet nuk ka konsumuar një mashtrim ne prokurim publik e cila do ishe ndesh me LPP përkatësisht nenin 65 dhe 99.2 te LPP-së. AK Policia e Kosovës Drejtoria e Prokurimit nuk ka neglizhuar por ka proceduar ne harmoni me LPP dhe rregulloret pasi qe një prodhues ka deklaruar se ka tërhequr nga linja prodhimit produktin ne fjalë. Për ketë ju bashkëngjisim te gjitha komunikimet autorizimet shkresat katalogët dhe emailit zyrtar.	konfiskoj sigurinë e tenderit. Njoftimi për kontratë ishte shpallur mbi një muaj para se Operatori Ekonomik të ketë sjellur autorizimin e prodhuesit. OE kishte pasur kohë të mjaftueshme për të konfirmuar nëse prodhuesi ishte duke prodhuar produktin në fjalë. Vetëm pas inicimit nga ana e Autoritetit Kontraktues drejtuar prodhuesit ishte konfirmuar nga ana e tyre se kjo linjë e prodhimit ishte ndërprerë nga fillimi i vitit 2024. Mbi këto informata ne kemi vlerësuar se AK ka pasur fakte dhe të drejtë që të konfiskoj sigurinë e tenderit. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
--	--

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
18			
DOKUMENTI DËRHOJË			
DOKUMENTI DËRHOJË			
Niveli Org.	Shit.Klasif.	Nr. Prot.	Nr. Faqeve
Org. Jedin.	Klasif. Kod	Prot. No.	Br. Stranica
Org. Unit	Class. Codn	Prot. No.	No. Pages
03	47	1042	20



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS - Vlada Kosova - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRASNJI POSLOVA	
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS	
Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister	
Nr. Ref./No.	Nr. ifaq. sh. / No. pg.
0342	1
Data/Date	
18.6.2025	
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnji Poslova
Ministry of Internal Affairs

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin
2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet përveç çështjes A4, dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Xhevdet Svecija

Ministër i deleguar i Ministrisë së Punëve të Brendshme
Data: 18.6.2025, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Sipas SNK 16 kostot e një pasurie zëri të aktiveve afatgjata materiale (Toka, ndërtesa, Makineri e pajisje), përfshinë: a) çmimin e tij të blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të rimbursueshme pasi zbriten (skontot) tregtare dhe zbritjet tregtare; b) çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjell aktivin në vendin edhe kushtete e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi; c) vlerësimin fillestar të kostove të zbërthimit dhe heqjes së zërit dhe restaurimi i vendit në të cilin ai është vendosur, detyrimin për të cilën një njësi ekonomike ekspozohet ndaj një detyrimi të tillë. a) çmimin e tij të blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të rimbursueshme pasi zbriten (skontot) tregtare dhe zbritjet tregtare; b) çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjell aktivin në vendin edhe kushtete e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi; c) vlerësimin fillestar të kostove të zbërthimit dhe heqjes së zërit dhe restaurimi i vendit në të cilin ai është vendosur, detyrimin për të cilën një njësi ekonomike ekspozohet ndaj një detyrimi të tillë.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.